

**VENDIM**  
**Nr. 569, datë 24.6.2015**

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE  
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË  
HIDROCENTRALIT “OSOJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh, për rezultatit teknik dhe financiar në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Osojë”, që i jepet shoqërisë “Osoja Energy” sh.p.k.
2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Osojë”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**